

# LETËR INFORMUESE

Letër informuese për prindërit

Botimi Nr. 5: Shtator - Dhjetor 2019



## Të dashur prindër,

Jemi në dhjetor dhe po i afrohem fundit të këtij viti. Përveç procesit mësimor, që nga shtatori e deri më tani Shkolla NEHEMIA ka organizuar një sërë aktivitete, për të cilat ju ftojmë të informoheni më poshtë.

Në fund të muajit shtator është zhvilluar takimi i parë me prindërit dhe ne ju përgëzojmë për zgjedhjet që keni bërë për këshillin e klasës dhe të shkollës, si dhe u urojmë të zgjedhurve një angazhim sa më të plotë

dhe me dedikim në bashkëpunimin prindër-shkollë. Ne jemi të hapur për të bashkëpunuar me ju dhe presim me padurim angazhimin dhe mbështetjen tuaj përgjatë vitit shkollor!

Prioritetet tona për këtë vit janë: mësimdhënia interaktive si dhe nxitja dhe stimulimi i iniciativës hulumtuese të nxënësve, të menduarit kritik e krijues nëpërmjet të nxënimit me projekte dhe atij me bazë zgjidhjen e problemit.

Për këtë qëllim kemi zhvilluar edhe trajnime të ndryshme me stafin mësimor dhe të tjera janë në planifikim.

Një mirëseardhje të veçantë i urojmë

stafit të ri mësimor që na është bashkuar në këtë vit shkollor dhe falenderojmë edhe praktikantët e Universitetit Ludwig-Maximilian në Mynih, për angazhimin e tyre tek Shkolla NEHEMIA.

Ju urojmë një lexim të këndshëm dhe festa të gëzuara.

Me respekt dhe për të ardhmen e fëmijëve tanë

Drejtorja e Shkollës NEHEMIA

*Elona Rira*  
[elona.rira@ng.team](mailto:elona.rira@ng.team)

*Donika Nasto*  
[donika.nasto@ng.team](mailto:donika.nasto@ng.team)



## Zhvillimi i mëtejshëm i shkollës

Duke u bazuar në të dhënat e mbledhura nga të gjithë personat e interesuar: mësues, prindër, nxënës etj. është hartuar plani strategjik 10-vjeçar për zhvillimin e mëtejshëm të shkollës. Zbatimi i këtij plani do të monitorohet vit pas viti, duke synuar gjithmonë e më shumë ekselencën dhe përgatitjen sa më të mirë dhe të gjithanshme të nxënësve tanë.

Një pjesë e ndryshimeve të paraqitura edhe në planin strategjik janë: trajnime specifike me në qendër të mësuarit me kompetenca, ngritja e një komisioni pranimit për nxënës të rinj të klasës së 10-të dhe përmirësimi i procedurës së pranimit, forcimi i partneriteteve si dhe metodat mësimore sa më konkrete.

Më poshtë janë pasqyruar disa trajnime të zhvilluara deri më tani:

- Trajnim me Prof. Dr. Werner Esser në muajin gusht, me temë "Mësimdhënia me kompetenca dhe individualizimi i mësimit"
- Trajnim me Dr. Osman Buleshkaj në muajin gusht, me temë "Të nxënët me projekte dhe të nxënët me bazë problemin"
- Trajnim me Dr. Rezarta Reimann në muajin nëntor, me temë "Të nxënët me kompetenca dhe standarde"

## Aktivitete ekstrakurrikulare me nxënësit

Falenderojmë të gjithë nxënësit pjesëmarrës për angazhimin e tyre në aktivitete të ndryshme! Jo gjithmonë është e lehtë të dalësh dhe të performosh por kjo është një mundësi e mirë për zbulimin dhe zhvillimin e talenteve të tyre, si edhe një parapërgatitje për arsimin e lartë dhe profesionin e së ardhmes.

Më poshtë disa aktivitete kryesore gjatë periudhës shtator- nëntor 2019:

### Kopshti:

- Vizitë te zjarrfiksj
- Vizitë në Shkollën AmaroTan
- Vizitë në bibliotekën e qytetit
- Kinemaja në kopsht

### Shkolla:

- Takime sensibilizuese kundër përdorimit të drogës, klasat VII – XII me z. Christoph Lipski, ekspert në Policinë Bavareze për parandalimin e drogës
- Aktivitet në kuadër të Ditës Europiane të Gjuhëve të Huaja
- Ekskursion në Korçë (Muzeu i Arimit, Muzeu Arkeologjik, Muzeu Mesjetar)
- Vizitë në Muzeun e Pogradecit
- "Talenti im", aktivitet në kuadër të muajit tetor, muajit të letërsisë dhe artit (klasat I-XII)
- Ekspozita me piktura dhe punime nga nxënësit
- Konkursi i historisë midis gjimnazeve të rrethit

për 75-vjetorin e Çlirimit të Shqipërisë (vendi i II-të)

- Takim informues, fushatë sensibilizuese në bashkëpunim me Muzeun e Pogradecit dhe Shërbimin Kombëtar të Rinisë, mbi përparësitë që ka, futja e Liqenit të Ohrit në zonat e mbrojtura nga UNESCO
- Kampionati i volejbollit, ku djemtë zunë vendin e parë në rang rrethi.
- Konkursi i letërsisë me ese
- Projekte sociale me nxënësit: shpërndarja e ushqimeve për njerëzit në nevojë; fushatë sensibilizimi kundër dhunës ndaj gruas në bashkëpunim me shoqatën "Unë gruaja"; fushatë sensibilizimi mbi bullizmin etj.

## Këndi i njoftimeve

- Në muajin dhjetor (19-23 dhjetor) është java e të mësuarit me anë të projekteve, një metodë bashkëkohore të mësuarit, e cila vendos në qendër nxënësin.
- 13 dhjetor, dita e takimit me prindërit (takime individuale, mësimi nga klasa I-XII nuk do të zhvillohet)
- Në datat 13-14 dhjetor në kampusin e Nehemiah Gateway Albania zhvillohet Pazar i Krishtlindjes, në të cilin do të jenë të angazhuar edhe nxënësit tanë.
- Data 23 dhjetor është mësim (zëvendësim i datës 27 nëntor) dhe më datë 6 janar rifillon mësimi.
- Faza e parë e projektit B@S (<https://www.business-at-school.net/>) do të zhvillohet në 11 dhjetor.

## I urojmë mirëseardhjen



**Elton Canellari**

Mësues histori-geografie, me një përvojë të gjatë në mësimdhënie dhe jo vetëm. Ka mbaruar studimet e larta për këtë degë si edhe studimet master. Ka një përvojë të çmuar në Zyrën Arsimore Pogradec dhe jemi të privilegjuar që e kemi sërish në mesin tonë.



**Boralda Shkëmbi**

Mësuese e gjuhës angleze, me shumë pasion për gjuhën dhe dashuri për fëmijët. Ka mbaruar studimet bachelor dhe master në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Tiranë dhe ka përvojë si mësuese e gjuhës angleze e midis të tjerash, edhe si gazetare.



**Kristjan Lleshi**

Mësues i edukimit fizik. Ka kryer studimet për këtë degë dhe për shumë vite ka qenë i angazhuar në ekipe të ndryshme futbolli. Ka përvojë si mësues dhe si trajner ekipi. Për ne, një vlerë e shtuar në stafin tonë.



**Luljeta Mani**

Mësuese për gjuhën e huaj gjermane. Ka kryer studimet master tek Shkolla e Lartë Nehemiah Gateway për Leadership dhe Vlerësim Arsimit dhe ka një përvojë disa vjeçare në mësimdhënie. Ka kryer një kualifikim 2-vjeçar në Hanover, Gjermani.



**Xhensila Cake**

Mësuese biologjie, diplomuar në Korçë me rezultate shumë të mira. Ka fituar zemrat e nxënësve që në fillim dhe me shumë përkushtim dhe dashamirësi është e dedikuar të japë maksimumin!

Si çdo vit, patëm kënaqësinë të mirëprisnim mësuesit praktikantë nga Universiteti Ludwig-Maximilian në Mynih, të cilët praktikuan aftësitë e tyre mësimore në Shkollën NEHEMIA, duke u dhënë një mundësi nxënësve të klasave III-XII të mësonin gjermanisht nga gjermano-folës.



**Fisnik Zeqiraj**

Në shtator-tetor 2019 isha për afërsisht 5 javë në

Shkollën NEHEMIA në Buçimas, Pogradec. Kur po kërkoja për vende praktike jashtë Gjermanisë, gjeta krejt rastësisht Shqipërinë dhe u befasova shumë. Prindërit e mi janë nga Kosova dhe ne shkojmë shpeshherë atje gjatë pushimeve verore.

Gjatë praktikës te Shkolla NEHEMIA kam pasur përvoja shumë të mira në mënyrën e trajtimit të nxënësve dhe me organizimin e mësimdhënies. Për më tepër, vizitova për herë të parë rajone në Shqipëri si Elbasani, Korça dhe më pëlqeu shumë.

Ju uroj suksese të mëtejshme në punën tuaj në shkollë! Vazhdoni të ecni plot disiplinë dhe vetëbesim, ashtu siç edhe ju njoha.



**Tizian Hegetusch**

Unë studioj për mësuesi në Mynih, në universitetin Ludwig-Maximilian dhe aty dëgjova për herë të parë për Nehemiah Gateway dhe mundësinë për të bërë praktikë tek Shkolla NEHEMIA. Më bëri shumë përshtypje filozofia e kësaj organizate dhe isha shumë i kënaqur kur mora miratimin për të bërë praktikën time këtu.

Detyra ime ishte kryesisht të mbështesja mësimdhënien e gjuhës gjermane në klasat VI deri XII. Këtu fitova një përvojë shumë të vlefshme në lidhje me mësimdhënien në shkollat shqiptare. Format e larmishme të mësimdhënies, komunikimi dhe ndërveprimi i ngrohtë, i respektueshëm dhe i sigurtë midis mësuesve dhe nxënësve më lanë një përshtypje të veçantë.

Unë jam shumë mirënjohës për përvojat që fitova, për mikpritjen e ngrohtë nga kolegët dhe përkujdesin e madh gjatë kohës që isha aty.

**Rr. Nehemia  
7304 Buçimas  
Albania**

**T: +355 83 600 403  
[www.nehemiah-gateway.al](http://www.nehemiah-gateway.al)**